



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

Nr. 01.400.25984

Dt. 15.06.2021



Për: Zyra Kombëtare e Auditimit, z. Besnik Osmani

Nga : Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit



Lënda: Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë:
" *Projektet e financuara nga Granti i Përformances Komunale për vitin 2019* "

Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, po ju dërgojmë Planin e veprimit për zbatimin e Rekomandimeve që dalin nga Raporti I auditimit me temën " " *Projektet e financuara nga Granti i Përformances Komunale për vitin 2019* "

PLANI

I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE QË DALIN NGA RAPORTI I AUDITIMIT TË PËRFORMANCESË

Nr.	Qështja	Aktiviteti	Përgjegjësit e aktiviteteve	Afati i realizimit
1	Prioretizimi i projekteve në të cilat investohet.	Gjatë dëgjimeve buxhetor, Komuna do të pranoj të gjitha kërkesat nga banorët e sajë dhe do t'i inkorporoj këto kërkesa në kornizën afatmesme buxhetore. Projektet të cilat nuk mund të mbulohen me buxhetin komunal do të vendosen në Listën rezervë të projekteve të cilat mund të financohen nga burime të ndryshme jashtë buxhetit komunal. Këto projekte do të prioretizohen (vlerësohen) sipas Udhëzimit Administrativ MF nr.06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioretizimin e projekteve kapitale (nenit 4 deri 8). Për identifikimin e projekteve do të përdoret edhe Strategjia komunale për investime.	Drejtoria e Infrastruktura Publike, Drejtoria e Financave	Shtator 2021
2	Aprovimi paraprak i projekteve	Pas vlerësimit dhe prioretizimit të projekteve, këto projekte do të aprovohen në nivelin komunal dhe do të dërgohen për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Çdo projekti të propozuar nga Komuna për aprovim nga Kuvendi i Komunes do të bashkangjitet vlerësimin paraprak.	Drejtoria e Infrastruktura apo Drejtoria respektiv dhe Drejtoria e Financave	Viti 2021
3	Inicimi i projekteve të prokurimit	Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit për projektin specifik, do të inicohet procedura e prokurimit në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregullat tjera, do të kërkohet sigurimi i buxhetit, deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve, dhe do të publikohet tenderi. Afati i përfundimit të të projektit do të jetë në harmoni me afatin e përcaktuar nga financuesi/donatori.	Zyra e Kryetarit Zyrtari Kryesor Financiar, Zyra e Prokurimit	Viti 2021
4	Proqesi i realizimit të projekteve	Projektet paraprakisht do të kenë projektet ekzekutive ku do të dihet saktësisht vlera e investimeve si dhe paramasa dhe parallogaria ekzekutive. Problemet pronësore do të eliminohen	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, Drejtoria e Inspektionit	Viti 2021

		me angazhimin e drejtorateve përkatëse si Drejtoratit për gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, si dhe Drejtoratit të inspektionit. Në rastet kur është e nevojshme do të inicohen edhe procedurat për shpronësim.		
4.1	Mbikqyrja e realizimit nga ana e Menaxherëve të Projekteve.	Pas nënshkrimit të kontratës me punëkryesin, në pajtim me nenin 61, pikat 1 deri 31 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, do të bëhet caktimi i Menaxherit të projektit dhe Mbikqyrësit të drejtëpërdrejtë të Menaxherit të projektit. Mbikqyrja dhe mënaxhimi do të bëhen në mënyrë permanente dhe raportimi i mbikqyrjes do të bëhet përmes modulit për menaxhimin e kontratës në formë elektronike të paraparë në Rregulla dhe Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik (01.02.2021).	Menaxheri/ Menaxherët e projektit Mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë i Menaxherit të projektit Zyra e prokurimit	Viti 2021